



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:284972

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766165

P.nr.337/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit H.Xh nga Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2072/23 të datës 15.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 24.05.2024, në praninë e prokurores së shtetit Vyrtyte Gërvalla, të pandehurit H.Xh, të dëmtuarit S.M, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 31.05.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: H.Xh, nga babai Z. dhe e ëma B., e gjinisë M., i lindur me dt. ..., Komuna Vushtrri, tani jeton në Suedi, me numër personal ..., ka të kryer fakultetin ekonomik, i martuar, prind i katër fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Më datën 14.11.2023 në Vushtrri, përmes telefonit, i pandehuri H.Xh, ka kanosur të dëmtuarin S.M, me fjalë se do ta privoj nga jeta me qëllim të frikësimit të tij, kjo pas kërkesës së të dëmtuarit për prishje të fejesës në mes të vajzës së të dëmtuarit A.Xh me djalin e të pandehurit D.Xh, duke i thënë se: “Ndash shko në polici ndash shko në Gjykatë, plumi ka me të prit në fund”, me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar frikë dhe pasiguri për jetën e tij.

- Me këtë ka kryer veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 181 par.2 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 364, 449, 452 dhe 462 të KPPRK-së:

E G J Y K O N

TË PANDEHURIT: H.Xh, i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej dymijë (2,000) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do

të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 200 (dyqind) euro dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 (njëzetë) euro. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuar S.M udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e arsytimit të aktgjykimit*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.2072/23 të datës 15.12.2023 të paraqitur pranë kësaj gjykatë, ka ngarkuar të akuzuarin H.Xh, me veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

### *Kompetenca e gjykatës*

Gjykata pasi që fillimisht ka vlerësuar kompetencën lëndore dhe territoriale, si dhe ka vlerësuar të metat formale dhe juridike të aktakuzës, duke vepruar sipas kësaj çështjeje penale, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 21.02.2024, ku ndërsa pas leximit të aktakuzës dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë ku i pandehuri ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë sipas aktakuzës. Në këto kushte gjyqtari i vetëm gjykues të pandehurin e ka njoftuar lidhur me veprimet të cilat mund ti ndërmar pas mospranimit të fajësisë e deri në shqyrtimin gjyqësor, përkatësisht të drejtën për të ushtruar brenda afatit ligjor kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhje të aktakuzës.

### *Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimi gjyqësor*

Pasi që i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës, gjykata më dt.23.05.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku palët kanë paraqitur fjalën hyrëse dhe gjykata ka vazhduar me rrjedhën e procedurës gjyqësore.

Prokurorja e shtetit, në fjalën hyrëse ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor në çështjen penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nën shenjën PP.II.nr.2072/23, ndaj të pandehurit H.Xh për veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par.2 të KPRK-së, do të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, meqenëse vepra e tillë *Kanosja* paraqet më tepër një deklaram personal që i përfshin dy persona, njërin si palë kanosëse dhe palën tjetër si palë e kanosur, çka nënkupton që forma e të provuarit të përgjegjësisë penale në aspektin faktik, ndërlidhet kryesisht me prova personale, që pastaj parimisht duhet të merren parasysh provat rrethimore për të vërtetuar dashjen dhe motivin e të pandehurit për të kryer këtë vepër penale. Ka theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor me

dëgjimin e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit S.M, do të vërtetohet kanosja që i është bërë nga ana e të pandehurit, shtuar këtu si provë mbështetëse edhe deklarimin e dëshmitares A.Xh. Tutje ka shtuar se, edhe nga deklarata e të pandehurit do të vërtetohet që i njëjti e ka kontaktuar me telefon të dëmtuarin, ndërsa nuk qëndrojnë arsyet që i pandehuri i ka dhënë në fazat paraprake, kjo pasi ky deklaram i tij është në kundërshtim me të gjitha provat që janë marrë nga prokurori i shtetit, e që janë prova të ligjshme dhe që pa asnjë mëdyshje në plotëni do të vërtetohen se, i pandehuri është përgjegjës për veprën që i vihet në barrë të kësaj aktakuze. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor, pas administrimit të të gjitha provave në shkresat e lëndës, është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri H.Xh ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së, vepër kjo e kryer në dëm të të dëmtuarit S.M. Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit S.M e dhënë paraprakisht në polici ku të njëjtat fakte janë vërtetuar edhe në këtë shqyrtim gjyqësor me deklarimin e tij më datë 23.05.2024 pranë kësaj gjykate, ku përmes kësaj deklarate vërtetohet se vajza e të të dëmtuarit ka qenë e fejuar me djalin e të pandehurit D. dhe pasi që ky i fundit jeton në Suedi, nuk ka arritur që ta marr vajzën atje, ku për këto arsye i dëmtuari ka kërkuar që të prishet fejesa dhe se nuk dëshiron që të vazhdon tutje.

Tutje ka deklaruar se fuqi provuese të këtij deklarami të të dëmtuarit, i jep edhe deklarata e dëshmitares A.Xh e dhënë edhe dje në shqyrtim gjyqësor, e cila para gjykatës ka treguar për arsyen e prishjes së fejesës, çka këto dy deklarata, pra e të dëmtuarit dhe dëshmitares, kanë treguar motivin që ka pasur i pandehuri në kryerjen e veprës penale, pasi që i njëjti edhe gjatë deklaramit të tij në fazat paraprake nuk është pajtuar me prishjen e martesës apo thënë më saktë, se te i pandehuri është krijuar përshtypja që ndërprerja e martesës nuk ka ndodhur me vullnetin e dëshmitares, por ka ndodhur me iniciativën e të dëmtuarit, çka kjo vërteton motivin si formë të veprimit me kryerjen e kësaj vepre penale, pasi që kjo vepër për vërtetimin e përgjegjësisë penale, duhet parimisht të bëhet edhe mbi bazën e provave rrethanore e që në rastin konkret është motiv që prokurori i shtetit e deklaroj më lartë. Thekson se shtuar këtu faktin se i pandehuri edhe pasi që është lajmëruar rasti në polici, ka tentuar që të kontaktoj me dëshmitaren – vajzën e të dëmtuarit, pra i pandehuri pasi është njoftuar në polici për zhvillimin e procedurës penale, tentoj të ndalojë dhe të kontaktojë me dëshmitaren, çka kjo tregon sjelljen dhe qasjen e tij të pakursyer në drejtim të vazhdimit të shqetësimit ndaj dëshmitares, e që drejtpërdrejtë ndërlidhet edhe me të dëmtuarin.

Po ashtu ka theksuar se në bazën e gjithë këtyre rrethanave, konsiderojnë se kjo çështje penale është ndriçuar në plotëni, dhe se i pandehuri është përgjegjës penalisht për veprën penale që i vihet në barrë. Ndërsa ka shtuar që në bazë të lartcekurave, i kërkojnë gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor, duke i shqiptuar një dënim me burgim efektiv, pasi që ekzistojnë rrethanat rënduese që e vërtetojnë se dënimi i tillë e arrin qëllimin e dënimit, si p.sh shkalla e lartë e dashjes e të pandehurit në kryerjen e veprës penale, respektivisht dashja direkte me qëllim të shkakimit të frikës tek i dëmtuari. Ka shtuar se rrethanë tjetër rënduese i propozojnë gjykatës, që të marrë edhe sjelljen jo korrekte të të pandehurit në këtë shqyrtim gjyqësor, ku të njëjtit nga gjykata në vazhdimësi i është tërhequr vërejtja, dhe po ashtu faktin se i njëjti tregon mos respekt në gjykatë duke lëshuar sallën e gjykimit. Ka theksuar që në këtë çështje penale P.SH nuk gjen asnjë rrethanë të vetme lehtësuese që mund të merret parasysh me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë

së dënimit, andaj i propozojnë edhe njëherë gjykatës që të bëj vlerësimin e rrethanave që u cituan nga P.SH., ashtu që të njëjtit t'i shqiptohet dënim adekuat në mënyrë që të plotësohet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

I dëmtuari në fjalën hyrëse ka deklaruar se e mbështet fjalën hyrëse të prokurores së shtetit dhe shton se kërkon kompensim dëmi lidhur me këtë çështje penale. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të Prokurores së shtetit dhe mbetet në tërësi pranë deklarimeve të dhëna më parë.

I akuzuari në fjalën hyrës ka deklaruar se nuk e ndjen veten të fajshëm dhe të gjitha këto janë të pavërteta. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se të gjitha ato që i ka thënë prokurori i shtetit janë të pavërteta, pasi që i dëmtuari ka qenë shkaktar i ndarjes së kësaj martese, ashtu siç është deklaruar në seancën e datës 23.05.2024, të gjitha veprimet deri tek kjo situatë janë ndërmarrë nga vet i dëmtuari, se i pandehuri nuk ka asnjë pikë faji në këtë çështje, pasi që nuk ka as fakte lidhur me këtë çështje penale.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet*

##### *Faktet jo kontestuese*

Për gjykatën është fakt jo kontestues se i pandehuri dhe pala e dëmtuar kanë qenë në raporte miqësie dhe atë djali i të pandehuri dhe vajza e të dëmtuarit kanë pasur martesë për më tepër se dy vite.

Gjithashtu fakt jo kontestues për gjykatën ishte edhe fakti se ditën kritike i dëmtuar e ka thirrë të pandehurin në telefon

Të gjitha këto fakte janë të pohuara edhe nga vetë palët.

##### *Faktet kontestuese*

Fakt kontestues për gjykatën dhe i domosdoshëm për tu provuar ishte fakti se i pandehuri a e ka kanosur përmes telefonit të dëmtuarin duke ju drejtuar të dëmtuarit me fjalët “*ndash shko në polici ndash shko në Gjykatë, plumi ka me të prit në fund*”?

##### *Si i ka vërtetuar gjykata faktet kontestuese*

Meqenëse i pandehuri me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë, nuk e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, gjykata për vërtetimin e faktit kontestues të lartë cekur, si element qenësor për përmbushjen e figurës së veprës penale me të cilën ngarkohet i pandehuri, ka zhvilluar procedurën e provave.

##### *Provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor*

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional, dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të pandehurit si dhe faktet në favor të tij duke i mundësuar të pandehurit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, ashtu që gjatë shqyrtimit gjyqësor bëri administrimin e këtyre provave:

*Provat materiale:* Raporti fillestar i incidentit me numër 2023-BD-1026 i datës 15.11.2023, Raporti i oficerit i datës 15.11.2023, Procesverbal i marrjes në pyetje të ankuesit – dëshmitarit S.M i datës 15.11.2023, Procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitares A.Xh i datës 15.11.2023, Procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitares A.Xh i datës 01.12.2023, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin H.Xh i datës 15.11.2023, Raport policor i datës 22.03.2024, Procesverbal i marrjes në pyetje për ankuesen – dëshmitaren A.Xh i datës 22.03.2024.

*Provat personale:* Dëgjimi i të dëmtuarit S.M në cilësi të dëshmitarit dhe dëgjimi i dëshmitares A.Xh në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 23.05.2024, ndërsa i pandehuri është deklaruar për çështjen penale në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 24.05.2024.

Nga Raporti fillestar i incidentit me numër 2023-BD-1026 i datës 15.11.2023, vërtetohet se me datën 15.11.2023 rreth orës 16:10, pranë Stacionit Policor në Vushtrri ishte paraqitur i dëmtuari S.M , i cili kishte deklaruar se vjehri i vajzës së tij e ka kanosur përmes telefonit duke i thënë “ndash shko në polici ndash shko në gjykatë se plumi ka me të prit në fund”. Sipas ankuesit, dhëndri nuk ka mundur ta marrë vajzën e tij jashtë Kosovës, për shkak të mos kompletimit të dokumentacioneve përrreth 2 vite e gjysmë, dhe e njëjta është ndarë.

Nga Raporti i oficerit i datës 15.11.2023 vërtetohet fakti se me datë 15.11.2023 rreth ores 16:10 në Stacionin Policor ne Vushtrri ishte paraqitur i dëmtuari S.M, i cili e ka njoftuar policinë se i njëjti është kërcënuar nga H.Xh përmes telefonit duke i thënë sipas ankuesit se “ndash shko në polici ndash shko në gjykatë se plumi ka me të prit në fund”, pasi të njëjtit kishin pasur miqësi mes vete, ku djali i H. dhe vajza e S. kishin qenë të martuar por djali nuk kishte mundur që ta marr në Suedi për rreth dy vite e gjysmë, për shkak të mos kompletimit të dokumentacionit dhe njëherit dy herë i ishte refuzuar viza vajzës dhe se rasti ishte iniciuar në njësinë e hetimeve për veprime të mëtutjeshme.

Nga Procesverbali i marrjes në pyetje të ankuesit – dëshmitarit S.M i datës 15.11.2023 vërtetohet se i dëmtuari S.M ka deklaruar se me datë 15.11.2023 rreth orës 16:10 ka ardhur në Stacionin Policor në Vushtrri lidhur me rastin që i ka ndodhur më datën 14.11.2023, pasi që H.Xh nga Vushtrria e ka kërcënuar përmes telefonit ku i kishte thënë: “ndash grahi me polic ndash grahi me gjykatë në fund ka me të prit plumi se unë rob nuk kam për me lan”. Tutje ka deklaruar se kanë qenë në miqësi me të, ku djali i tij D. me vendbanim në Suedi ka qenë i fejuar me vajzën e këtui të dëmtuarit A. për rreth 3 vite, pasi që D. nuk kishte mundur që ta merrte vajzën në Suedi, ku para tri javëve i ishte refuzuar viza vajzës, vajza kishte deklaruar se e prish fejesën dhe martesën me të dhe nuk do të vazhdoj me të më. Ka deklaruar se djali nuk e ka kërcënuar e as nuk i ka thënë asgjë as më parë e as tash, mirëpo prindi i djalit H.Xh e kishte kërcënuar me fjalët

si më lart. Tutje ka shtuar se ndihet i kërcënuar nga H. dhe po ashtu nuk ndihet i sigurt për sigurinë e vajzës së tij A., andaj dëshiron që të deklarojë se i njëjti mund që në të ardhmen këtij ose vajzës të u bëj ndonjë problem apo ndonjë të keqe. Tutje ka deklaruar se asnjëherë nuk ka pasur probleme me H., kanë pasur marrëdhënie miqësore me të, mirëpo prej datës 25.10.2023 kishin filluar problemet ku i ishte refuzuar viza vajzës për arsye se ish-dhëndri nuk kishte mjete të mjaftueshme financiare që ta mbaj atë. Në fund ka deklaruar se nuk ka asgjë për të shtuar, mirëpo është i frikësuar për sigurinë e vajzës.

Nga Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares A.Xh i datës 15.11.2023, i dhënë në polici, vërtetohet fakti se dëshmitarja A.Xh është paraqitur me datë 15.11.2023 pranë Stacionit Policor në Vushtrri, e cila ka deklaruar se ka qenë e martuar me D.Xh nga Vushtrria, me vendbanim në Suedi për rreth dy vite e gjysmë, dhe se i njëjti nuk ia ka rregulluar letrat për të shkuar tek ai, dhe pasi që i ishte refuzuar viza për dy herë dhe herën e fundit rreth para tri javëve ka vendosur që të ndahet prej tij dhe ka vendosur përmes avokates që të prish kurorëzimin. Tutje ka deklaruar se prindi i saj S.M ka kontaktuar me D. dhe me ish-vjehrrin H.Xh, që të bisedojnë dhe të mos vie puna që të rriten gjërat, por të bisedojnë si miq për të gjetur ndonjë zgjidhje, mirëpo i njëjti nuk ka komunikuar me të apo babain e saj dhe çdo herë e ka justifikuar bisedën. Ka deklaruar që nuk ka asnjë presion nga askush për shkuroëzim, por që ndihet e kërcënuar për prindërit e saj. Ndërsa ka theksuar se nuk e ka dëgjuar H.Xh duke e kërcënuar babain e saj, pasi që ata kanë biseduar përmes telefonit. Ka theksuar se nuk ka asgjë për të shtuar lidhur me rastin, por kërkon nga ai dhe familja e tij që të mos e shqetësoj atë dhe familjen e saj që të vazhdoj jetën e qetë.

Nga Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares A.Xh i datës 01.12.2023, vërtetohet fakti se dëshmitarja A.Xh është paraqitur në Stacionin Policor në Vushtrri, e cila ka deklaruar se ka qenë e fejuar me D.Xh dhe është ndarë me të dhe se e ka paraqitur një rast në polici më 15.11.2023 dhe prej asaj kohe nuk kanë pasur kontakt me asnjë familjar të ish të fejuarit të saj. Kurse më datë 01.12.2023 rreth orës 12:38, ka qenë vetëm tek varrezat e qytetit duke shkuar të bëjë pagesën e rrjetit dhe aty ka ardhur me veturë ish vjehri i saj H.Xh duke bërë me bori që të ndalojë, ajo nuk është ndalur dhe as nuk ka folur me të, kurse ai kur e ka parë që ajo nuk po ndalon, ka zbritur nga vetura, kishte ardhur prapa saj diku rreth 500-600 metra duke i bërë presion dhe duke i thënë “A., nalu të bisedojmë dy minuta, pse spo nalesh qa tkom bo une ty”, kur e ka parë që nuk po ndalet duke ardhur prapa saj, e ka telefonuar policinë dhe ai pasi që e ka kuptuar që e ka telefonuar policinë i kishte thënë “Apet ki mu taku me mu” duke u larguar në drejtim të automjetit të tij. Ka theksuar se H.Xh ka qenë afër saj diku rreth 1-2 metra dhe se nuk kanë pasur kontakt fizik. Tutje ka deklaruar se nuk ka pasur ndonjë fjalë kërcënuese nga ana e tij, vetëm se po e shqetëson duke ardhur prapa saj, saherë që ajo del në qytet. Tutje ka theksuar se ndihet e shqetësuar, pasi që i njëjti nuk po e lë rehat, saherë del në qytet kur e sheh i vie pas saj duke e lutur që të bisedojë me të. Ndërsa që ka shtuar se dëshiron që ai ta lë rehat, të mos i shkojë pas sepse ndihet e shqetësuar dhe nuk mundet të dal rehat vetëm në qytet nga prezenca e tij.

Nga Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin H.Xh i datës 15.11.2023, vërtetohet se pranë Stacionit Policor në Vushtrri, i dyshuari H.Xh ka deklaruar se djali i tij D.Xh është fejuar me A.M rreth dy vite më parë dhe fejesa e tyre ka qenë çdo gjë në rregull dhe se e kanë kaluar shumë mirë, dhe djali i tij D. me A. kanë bërë kurorëzimin menjëherë pas fejesës dhe ka filluar

me përgatitjen e dokumenteve për bashkim familjar, por arsyeja e parë e refuzimit ka qenë sepse banesa që e ka pasur D., nuk i ka plotësuar kushtet për bashkimin familjar, dhe djali i tij D. është detyruar të marrë një banesë më të madhe, me të cilën ka aplikuar sërish por edhe atë ia kishte refuzuar emigracioni, për shkak se çmimi i qirasë së banesës ka qenë shumë i madh dhe se shumica e pagës që D. e merr, shkon për banesë, ndërsa pjesa tjetër mbetet për shpenzime personale, kështu që është shumë e vogël dhe është refuzuar nga emigracioni për herën e dytë, dhe D. është detyruar të merr banesën e tretë, e cila i ka plotësuar kushtet për bashkim familjar, por S.M nuk ka dashur që të vazhdoj lidhja e D. me A., dhe për këtë e kishte njoftuar përmes telefonit, e pas kësaj iu kishte drejtuar me fjalët se arsyeja që nuk dëshiron që të vazhdoj kjo miqësi, është se e kanë mbajtur vajzën peng dy vite dhe nuk e kanë marrur në Suedi. Tutje ka deklaruar se pas këtyre fjalëve ky i ka thënë që të mos ngutet se kjo punë kryhet, pasi që nuk varet prej tyre, se për dëshirën e tyre do ta kishin marrë menjëherë, dhe se i ka shkruar A. duke i thënë që të mos ngutet, sepse kjo punë kryhet dhe nuk e beson që do të zgjatë shumë, ndërsa që A. nuk ia kishte kthyer mesazhin. Ndërsa që ka theksuar se është në gjendje që, menjëherë pas rregullimit të dokumentacioneve, ta marr A. në Suedi, pasi që vajzën e kanë për qejfi dhe se nuk kanë pasur probleme asnjëherë. Tutje ka shtuar se nuk ka biseduar ndonjëherë me vajzën pas kësaj, sepse ua ka bllokuar të gjithëve telefonat. Ndërsa që ka theksuar se, nuk e ka kërcënuar me ndonjë fjalë e as nuk i ka thënë ndonjë fjalë fyese S.M, përkundrazi ai e ka kërcënuar dhe i ka thënë se vëllaznillëkun e ka mbledhur, dhe një prej anëtarëve të S.M që ka dyshuar se është axha i tij, e ka telefonuar dhe i ka thënë “me S. nuk ke punë më tash ke punë me neve”. Ka deklaruar se dyshon që S.M është duke i bërë presion A. dhe se ndarja nuk është dëshira e A.. Ndërsa që ka shtuar se nëse A. nuk pranon të vazhdoj kjo lidhje, i njëjti pajtohet me vendimin e saj pa marrë parasysh, sepse nuk e detyron askënd dhe se i vie keq që po ndodhë kjo dhe nuk e ka pritur që të ndodhë kjo gjë.

Nga Raporti policor i datës 22.03.2024 vërtetohet se më datë 22.03.2024 rreth orës 11:30, përmes imellës nga Stafi i Spitalit të QKUK-së në Prishtinë, H.H-G. punonjëse në Gjinekologji – Prishtinë, e ka njoftuar policinë se në Gjinekologji është e shtrirë A.Xh nga Vushtrria, e cila ka shkuar që të lindë, mirëpo sipas viktimës dhe familjarëve të saj ndjehen të rrezikuar, pasi që ka probleme të vazhdueshme me bashkëshortin e saj D.Xh, i cili jeton jashtë shtetit, dhe sipas znj.H. viktima gjatë qëndrimit në gjinekologji nuk ndihet e sigurt. Tutje nga raporti deklarohet se pasi janë kthyer nga Prishtina, policia me kërkesën e babait të A., S.M, kanë shkuar në shtëpinë e tij që të marrin një deklaratë nga A., e cila ka deklaruar se kishte qenë e fejuar me personin D.Xh me vendqëndrim në shtetet perëndimore për afër dy viteve, por që nga muaji tetor i vitit 2023 e kishte prishur këtë fejesë, pasi që sipas saj nuk ka mundur ti rregullojë dokumentet, dhe pasi që ishte ndarë, e njëjta e kishte kuptuar se ishte shtatzënë dhe për këtë e kishte njoftuar vjehrrin e saj, pasi që me ish-burrin e saj më nuk kishte pasur kontakt, që sipas saj ish vjehrrin H.Xh e kërcënon këtë dhe familjen e saj duke u thënë se do t’ua shkatërrojë familjen, dhe duke ardhur herë pas here deri afër shtëpisë së tyre, hera e fundit kur kishte qenë ish vjehrrin i saj tek lagja e saj ka qenë para dy muajve, dhe për këtë ankuesja ka kërkuar urdhër mbrojtës nga Gjykata, pasi që sipas ankueses, tani, pasi që e ka lindur fëmijun e ka lënë në QKUK-Gjinekologji në Prishtinë, pasi që sipas saj nuk ishte e sigurt ta merrte fëmijën në shtëpinë e babait, e po ashtu nuk ka as të ardhura që ta rris këtë fëmijë. Tutje në lidhje me këtë, policia ka tentuar ta kontaktojë ish vjehrrin e saj H.Xh me nr. ..., për ta njoftuar që të vijë në Stacionin Policor në Vushtrri për të dhënë

deklaratë, por i njëjti nuk ka pasur qasje, dhe po ashtu nuk kanë pasur as adresë apo rrugë të shtëpisë së tij, dhe se për rastin ishte njoftuar prokurori kujdestar.

Nga Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares A.Xh i datës 22.03.2024, vërtetohet fakti se dëshmitarja A.Xh është paraqitur në Stacionin Policor në Vushtrri, e cila ka deklaruar se pasi që është ndare me D., me të cilin kanë qenë të fejuar rreth dy vite, por pasi që nuk ka mundur t'ia rregullojë dokumentet, janë ndarë. Ka deklaruar se në muajin dhjetor e ka kuptuar që është shtatzënë dhe për këtë e ka njoftuar ish vjehrrin e saj H.Xh, dhe i njëjti e ka mohuar duke i thënë “na nuk marrum kopila”. Ndërsa që ka shtuar se, ka ardhur edhe nëna e burrit të saj tek shtëpia e saj, duke e kërkuar që ti dalë përballë dhe t'i jap sqarime. Tutje ka theksuar se është ndarë dhe e ka prishur fejesën më 25 tetor 2023, burri i saj nuk e ka telefonuar dhe as nuk është interesuar se pse është ndarë nga ai, ndërsa vjehrrin duke i kërcënuar të gjithë familjen dhe duke u thënë se do të ua shkatërrojë familjen, e nga kjo është e frikësuar shumë dhe nuk janë të sigurt asnjë nga familjarët e saj e as ajo, dhe për këtë kërkon urdhër mbrojtje nga gjykata. Ka deklaruar se do të qëndrojë këtu me familje, ndërsa që fëmijën e ka lënë në QKUK-Gjinekologji, pasi që nuk ishte e sigurt ta merrte në shtëpinë e babait e poashtu edhe nuk ka të ardhura ta rris fëmijun. Tutje ka shtuar se vjehrrin i kishte thënë “nuk marrim kopila”, ndërsa me burrin e saj nuk ka pasur asnjë kontakt. Ndërsa që ka shtuar se kërkon nga ish vjehrrin i saj që mos ta shqetësojë në asnjë mënyrë, sepse vie shumë shpesh në lagjen e saj, dhe se hera e fundit kur ka qenë ish vjehrrin i saj në lagjen e saj, ka qenë para dy muajve, dhe e ka vërejtur veturën e tij me katër treguesit e ndezur, dhe në atë moment ishte babai i saj duke shkuar në punë, e kishin thirrur policia pasi që ish vjehrrin i saj kishte denoncuar rrejtshëm për babain e saj.

### *Provat personale*

*I dëmtuari S.M* në cilësi të dëshmitarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 23.05.2024 ka deklaruar se e mbështetë deklaratën e në polici më datë 15.11.2023. Tutje ka deklaruar se të pandehurin e ka pasur mik, përkatësisht ka qenë vjehrrin i vajzës dhe se vajza e tij ka qenë e fejuar me djalin e të pandehurit 2 vite e gjysmë. Ka deklaruar se vajza e tij ka pasur bashkësi faktike me djalin e të pandehurit, vetëm gjatë pushimeve të verës dhe të dimrit dhe se e njëjta ka shkuar me djalin e të pandehurit dhe kanë fjetur së bashku, pasi që i njëjti jeton në Suedi, ndërsa vajza e tij jeton në Kosovë, në shtëpinë e të dëmtuarit. Tutje ka shtuar se vajza e tij nuk ka jetuar bashkë me djalin e të pandehurit, për shkak se ju ka refuzuar viza, dhe pas një viti e gjysmë ka ardhur i pandehuri e ka marrë vajzën e tij, dhe i njëjti e ka njoftuar vajzën se i është refuzuar viza, vajza i ka thënë se si i është refuzuar kur ka pritur që një vit e gjysmë, i pandehuri i ka thënë se e kanë nisur përsëri procedurën për vizë që një muaj e gjysmë, dhe më pas kur janë bërë dy vite e gjysmë një tezak i kushëririt të tij i cili jeton në Suedi, i kishte kërkuar të njëjtit që t'i ndihmojë se i ka bërë vajza dy vite e gjysmë, i njëjti i ka thënë t'ia jap numrin djali i të pandehurit D., numrin e telefonit ose facebook-un, dhe në qoftë se i kthehet pozitiv, le të vazhdojë, por nëse i kthehet negativ, t'i marr letrat e emigracionit dhe më pas ai do ta shoh se ku është problemi dhe do ta rregullojë atë punë. Ndërsa që i pandehuri i ka thënë se mund të shkojë së bashku me D. tek R.K, tek i cili nuk kanë shkuar. Ka shtuar se arsyeja e prishjes së fejesës ka qenë për shkak të mos rregullimit të vizës, dhe i njëjti e ka thirrur edhe vajzën dhe i ka thënë se është problemi për dy letra, dhe gjatë kësaj bisede kanë biseduar ai, i pandehuri dhe R.K, dhe aty e kanë kuptuar se për



shkak të pagës së vogël nuk mund ta marr në Suedi, ndërsa nga i pandehuri u janë dhënë arsye të tjera, si psh banesa dhe mungesa e dy dokumenteve, ndërsa që pas këtyre komunikimeve e ka njoftuar vajzën e tij dhe e njëjta i kishte thënë se nuk donë që ta marrin atje dhe po gjejnë arsye të ndryshme, pastaj axha i tij e ka thirrur H.Xh dhe i ka thënë: “o mik ne nuk kemi rob me nal, pasi që je pensioner a mund të vini pas një jave ose dy që ta zgjidhim këtë problem”, por nuk ka ardhur, kanë shkuar me axhën dhe vëllaun e tij tek vëllau i H., vëllau i tij i ka futur brenda dhe i ka respektuar dhe i ka thënë se aty e kanë S. me axhën e tij dhe me vëllaun e tij dhe e ka pyetur se çka është puna këtu, i njëjti i ka thënë se a janë ata njerëz normal dhe çfarë kanë ardhur për këtë çështje tek ju dhe i njëjti e ka mbyllur telefonin, pas dy tri dite ka ardhur në Kosovë, pasi që i ka vdekur nëna dhe ka ardhur tek shtëpia e tyre dhe i ka thënë gruas së tij se ka ardhur që të bisedojë me S.. Tutje ka deklaruar se nuk ka qenë në shtëpi, ka qenë duke punuar, dhe i njëjti e ka thirrur në telefon dhe i ka thënë se ka ardhur që të bisedojë për këtë punë, nga i njëjti ka kërkuar që fillimisht ta përfundojë të pamën e nënës së tij dhe ky më pas ta merr një ditë pushim, në mënyrë që ta rregullojnë këtë punë, i njëjti nuk ka ardhur, por ka ardhur gruaja e tij, e cila është sjellur nga i pandehuri dhe gruaja e tij ka ardhur në oborr të shtëpisë së tyre dhe gruaja e tij i ka thënë gruas së të dëmtuarit se keni me na e parë sherrin, dhe se këto fjalë i ka thënë për shkak të prishjes së fejesës, sepse kanë kaluar më shumë se dy vite e gjysmë. Tutje ka shtuar që data 14.11.2023 ka qenë data kur ka qenë bashkëshortja e të pandehurit në shtëpinë e tyre, dhe kur e ka njoftuar gruaja e tij, e ka thirrur H. në telefon dhe i ka thënë se nuk ka nevojë që ti thërras gratë, por takohen dy familjet, edhe një herë i ka thënë se nëse e sjell gruan apo dikënd tjetër, do ta lajmërojë rastin në polici, i njëjti i ka thënë “ndash lajmëroje rastin ose mos e lajmëro, plumi do të pret”. Ka shtuar se mendon se kjo çështje mund të zgjidhet vetëm mes burrave, dhe e ka ndjerë veten të frikësuar dhe të kërcënuar nga fjalët e të pandehurit. Ndërsa në pyetjen e gjykatës ka deklaruar se i pandehuri e ka thënë edhe fjalën “unë rob nuk kam me lënë”.

Dëshmitarja A.Xh në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 23.05.2024 ka deklaruar se qëndron pranë deklaratave të dhëna në polici të datës 15.11.2023 dhe 01.12.2023. Ka deklaruar se ka qenë e fejuar me D.Xh dy vite e gjysmë, por kanë pasur edhe kurorëzim, dhe arsyeja e lidhjes së kurorës ka qenë që të shkojnë në Suedi dhe të jetojnë së bashku, dhe se ka pritur dy vite e gjysmë që të shkojë, por asnjëherë nuk ka shkuar. Tutje ka shtuar se raportet nuk kanë qenë edhe të mira, i njëjti nuk ka shkruar shpesh, po ashtu nuk është interesuar për gjendjen e saj, i njëjti nuk e ka lejuar të studiojë, të punojë. Ka theksuar se më datë 25.10.2023, në një faqe suedeze e ka kuptuar se i është refuzuar viza, pastaj e ka thirrur D. dhe i ka thënë se çfarë ka ndodhur, i njëjti i ka thënë se është në punë dhe mos ta pengojë, më pas e ka thirrur prindin e tij dhe ia ka dërguar foton e refuzimit të vizës, i njëjti i ka thënë që të pres deri sa të vie D., më pastaj e ka thirrur D., i njëjti i ka thënë që të mos ngutet, se do ta rregullojnë, këtë ia kishte thënë në shaka, ndërsa kjo i kishte thënë se do të flasin me babain që ta rregullojnë këtë punë, më pas nuk ka folur më me D.n, prej asaj dite, pasi që i njëjti nuk e ka thirrur në telefon, dhe i ka thënë babait se nuk ka asgjë prej kësaj pune, dhe i ka thënë edhe të prishë kurorëzimin. Ndërsa ka shtuar se është e vërtetë se babai i saj e ka thirrur të pandehurit, me qëllim të rregullimit të situatës, dhe se babai i saj i ka treguar se i pandehuri e ka kanosur të njëjtin, dhe se i beson plotësisht babait të saj. Tutje ka theksuar se më datë 01.12.2023 ka shkuar që ta paguajë rrjetin kabllor në “A...”, dhe i pandehuri ka qenë të rruga dhe nuk e ka parë fillimisht, i njëjti i ka rënë edhe borisë së veturës, pasi që e ka parë që i njëjti është vjehri i saj, e ka thirrur babain e saj në telefon dhe i ka treguar që i njëjti është duke

e ndjekur prapa, pasi që i njëjti e ka ndalur veturën, më pas e ka thirrur dy tri herë “A. ndalu se dua të flas me ty”, por që nuk është ndalur por e ka thirrur policinë, i njëjti kur e ka kuptuar se është duke folur me policinë, është larguar dhe i ka thënë se do të shihen prapë, distanca ka qenë 1-2 metra, dhe që pas këtij rasti nuk ka pasur kontakt me D.. Tutje ka deklaruar se në muajin dhjetor e ka kuptuar që është shtatzënë me ish bashkëshortin e saj, dhe babai e saj e ka njoftuar dhe e kanë lënë që të takohen, i pandehuri e ka thirrur babain e saj dhe i ka thënë se pse dëshirojë që të takohen për këtë punë, ata nuk marrin fëmijë kopila në shtëpi. Ka shtuar se më nuk kanë pasur kontakt me D.. Ka theksuar se kur ka shkuar në repartin e gjinekologjisë në Prishtinë, ka biseduar me një person për rastet sociale, pasi që i ka thënë se janë në procedurë gjyqësore, e njëjta i ka thënë se duhet ta thërrasin policinë pasi që është rasti në gjykatë, ndërsa që është e vërtetë që ka kërkuar urdhër mbrojtje, sepse është ndjerë e kërcënuar edhe pse me të njëjtin nuk ka pasur kontakt, por që i njëjti ka folur me personat tjerë të përbashkët. Ka shtuar se me të pandehurin nuk jetojnë afër, por jetojnë në fshatra të ndryshme, por që e ka parë te lagja e saj, dhe kjo është arsyeja se ndihet e rrezikuar. Ndërsa ka shtuar se fëmijun e ka lënë në spital dhe u ka thënë se atë fëmijë nuk mund ta marrë, sepse nuk ka kapacitet për ta mbajtur. Ndërsa në pyetjen e të pandehurit ka deklaruar se D. i ka thënë që të mos punojë.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 24.05.2024 lidhur me çështjen penale ka deklaruar se djali i tij ka qenë i martuar me A.Xh, por nuk kanë qenë të martuar, kanë qenë të fejuar, kanë pasur kurorë dhe herë pas here janë takuar dhe kanë qëndruar së bashku në pushime me natë të tëra. Ka deklaruar se gjatë këtyre dy vite e gjysmë, D. ka jetuar në Suedi, ndërsa A. në Kosovë, dhe se është njoftuar nga i dëmtuari S.M se dëshiron që të prish lidhjen martesore mes djalit të tij dhe A.. Ka shtuar se nuk është e saktë që i dëmtuari i ka thënë se arsyeja që ai dëshiron ta prish fejesën është mbajtja peng e vajzës për dy vite e gjysmë. Ka theksuar se në procesverbalin e datës 15.11.2023, qëndron nënshkrimi i tij. Ka deklaruar se është e saktë që prishja e martesës ka ndodhur pa vullnetin e vajzës, por me iniciativën e të dëmtuarit, dhe se me datë 14.11.2023, pasi që është njoftuar për prishjen e fejesës, ka kontaktuar me të dëmtuarin në telefon, ndërsa që nuk ka kontaktuar me A. Ka deklaruar se është e vërtetë që i ka shkruar A., por nuk ia ka kthyer mesazhin, dhe e njëjta i ka bllokuar të gjithë familjes mundësinë e kontaktimit, pasi që ka marrë udhëzime nga prindi i saj për këtë. Ka shtuar se i ka shkruar A., sepse qëllimi i tij ka qenë që kjo martesë të mos priset, për faktin se kanë bërë shpenzime të mëdha për të, dhe se asnjëherë nuk ka qenë i pajtimit që kjo lidhje martesore të priset, madje ia ka dërguar dhëndrin e tij për të lënë anash problemet që kanë pasur dhe për të vazhduar miqësinë, por i dëmtuari nuk ka pranuar. Ndërsa ka shtuar se S.M pra i dëmtuari i ka bërë presion A. me qëllim të shkëputjes së martesës. Tutje ka deklaruar se më datë 01.12.2023, e ka takuar A. tek varrezat e qytetit dhe ka dashur ta kuptojë se a ka qenë vullneti i saj për tu ndarë apo e ka pasur të imponuar. Ndërsa ka theksuar se është e vërtetë që bashkëshortja e tij ka qenë në shtëpinë e të dëmtuarit pasi ka ndodhur ngjarja, dhe ka shkuar me qëllimin që t’ia marr mendimin A., por nëna e A. nuk e ka lejuar të dalë jashtë. Ka shtuar se nuk i ka parë se i dëmtuari se bashku me axhën dhe vëllain e tij, pas ngjarjes, kanë shkuar në shtëpinë e vëllaut të tij, por përmes tel. e kanë njoftuar vëllezërit se kanë ardhur, por që nuk e ka ditur arsyen e shkuarjes së tyre pasi që kjo çështje ka qenë e rregulluar sepse kanë pasur miqësi të mirë. Ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni për shtatzëninë e A., por e ka kuptuar pas 7 muajsh, S. fillimisht i ka njoftuar vëllezërit e tij e pastaj ata e kanë njoftuar. Ndërsa në pyetjen e gjykatës ka deklaruar se më datë 14.11.2023,

S. e ka thirrur në telefon, dhe me të kanë biseduar rreth çështjes së A. dhe D., dhe i njëjti i ka thënë: “nuk du më të pa tek shtëpia ime”, ndërsa ky i është përgjigjur se këto punë nuk kryhen aq shpejtë, se do të bisedojnë edhe me njerëz për të kuptuar se ku është arsyeja e ndaljes dhe i ka thënë se: “unë nuk kam rob për të lëshuar”, ndërsa i njëjti i është përgjigjur se ka marrë fund kjo punë, ka shtuar se i ka thënë se nuk mund të marrë fund kjo punë, sepse ka bërë shpenzime të mëdha lidhur me fejesën dhe martesën e tyre, janë shkaktuar mbi 25,000.00 euro shpenzime lidhur me banesën dhe tjera gjëra, dhe nga i njëjti ka kërkuar që t’i kthej sendet të cilat ia kanë blerë, i njëjti i ka thënë se këtë punë ia lë gjykatës, ndërsa i pandehuri i ka thënë se nuk ka punë me gjykatë, e më pas ai nuk ka pranuar, por që i pandehuri nuk e ka kanosur, i njëjti i ka thënë vetes se sikur këto provokime po bëhen me qëllim të hyrjes në lojë deri tek vrasja. Në fund ka theksuar se nuk ka pasur ndonjë tensionim të situatës gjatë komunikimit të tij me S.

### *Gjendja faktike e vërtetuar nga ana e gjykatës*

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi, pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, analizimit të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, si dhe shikimit në shkresat e lëndës vërtetohet kjo gjendje faktike: se i akuzuari me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka ndërmarrë veprimet inkriminuese për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata shqyrtoj me vëmendje të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atyre që gjenden në shkresat e lëndës dhe provave të cilat shfaqin lidhshmërinë e plotë të të pandehurit me veprën penale të kryer u fali besim të plotë, pasi që të njëjtat janë marrë në procedurë të rregullt ligjore, e sidomos gjykata i fali besimin deklarimeve të dëshmitares A.Xh dhe të dëmtuarit S.M, pasi që të njëjtat ishin në përputhje të plotë me njëra tjetrën dhe të njëjtat gjejnë mbështetje edhe në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Ndërsa sa i përket të pandehurit, i njëjti edhe pse kishte mundësi që të ofronte prova që do të vërtetonin pafajësinë e pretenduar të tij, nuk ka ofruar asnjë provë dhe nuk ka bërë asnjë propozim që do ti kontribuonte këtij qëllimi, ose më saktë në asnjë formë nuk ka arritur ta provoj se nuk ka kryer veprën penale, e gjithashtu edhe pse nuk e pranonte fajësinë dhe është deklaruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, i njëjti nuk ka ofruar ndonjë fakt që do të provonte të kundërtën.

Neni 181 paragrafi 2 i KPRK-së përcakton se formën themelore të veprës penale *Kanosja*, ashtu që theksohet se “*Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme...*, e për të cilën është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit.

Nga provat në shkresat e lëndës dhe provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, u vërtetua mjaftueshëm se i pandehuri ka ndërmarr veprimet ashtu siç përshkruhet në dispozitivin e aktakuzës, duke e kanosur të dëmtuarin, elemente këto që paraqesin figurën e veprës penale nga neni 181 par.2 të KPRK-së, andaj të njëjtin gjykata e gjykoj me dënim me gjobë në shumën prej dymijë (2000) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

*Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat, por pa u kufizuar si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti se i njëjti nuk ka qenë më parë i gjykuar për ndonjë vepër penale. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, faktin se i pandehuri nuk kishte shfaqur kurrfarë pendimi për kryerjen e veprës penale, sjellja jo korrekte e të pandehurit në seancë, ku të njëjtit nga gjykata në vazhdimësi i është tërhequr vërejtja dhe po ashtu faktin se i njëjti ka treguar mos respekt në gjykatë, duke lëshuar sallën e gjykimit.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e përshkruara më sipër gjykata të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke gjetur se ky dënim është dënim adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim ndaj tij, do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së. Duke i pasur parasysh të gjitha këto nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me i butë ose me i rëndë.

*Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës, kompensimin e viktimave, si dhe kërkesën pasurore juridike*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 dhe nenit 452 të KPPRK-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e mori në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata ka vendosur konform nenit 462 par. 2 të KPPRK-së, në të cilin parashihet që *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.”*

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.337/23, datë: 31.05.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.